



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Njoftim për Moratorium

Sipas ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 50 të Ligjit për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre, Ligji Nr. 04/L-035 që ka hyrë në fuqi më 26.10.2011 (Ligji), lidhur me Vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. SCR-05-001, të datës 09.03.2006, si dhe vendimit pasues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. SCR-05-001-R008, R009 dhe R011, të datës 19.05.2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit (Agjencia) shpall këtë njoftim lidhur me Ndërmarrjet Thelbësore të Trepçës dhe Ndërmarrjet Tjera të Trepçës (shih listën më poshtë):

A. Prej datës 8 Nëntor 2011 të gjitha veprimet, procedurat dhe veprimet e çfarëdo lloji që kanë për qëllim përcaktimin e vlefshmërisë, zbatimin apo përmbytjen e kërkesave apo interesave lidhur me Ndërmarrjet e cekura në këtë njoftim, apo Pasurisë së tyre, pezullohen dhe mund të vazhdojnë vetëm me lejen e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet Lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gjykata).

B. Këto veprime, procedura dhe akte të pezulluara përfshijnë, por nuk kufizohen në ndonjë veprim, procedurë apo vendim, duke përfshirë veprime, procedura, apo vendime gjyqësore:

- 1) lidhur me mbledhjen, shqyrtimin apo zbatimin e kërkesave për borxhe, taksa, ndëshkime apo çfarëdo obligimi;
- 2) lidhur me krijimin, njohjen, ndryshimin, rritjen, përkryerjen, regjistrimin apo zbatimin e çdo kërkesë apo interesi kundër apo të Ndërmarrjes apo Pasurisë së Ndërmarrjes;
- 3) çdo veprim për të realizuar, marrë apo shitur ndonjë aset që është lënë peng apo hipotekë apo të ngarkuar në ndonjë mënyrë, apo për të ushtruar pronësi apo kontroll mbi ndonjë Aset të Ndërmarrjes; dhe
- 4) procedurat apo veprimet rregullative lidhur me parandalimin apo sanksionimin e ndonjë shkelje të dispozitave rregullative, rregullave apo vendimeve, deri në atë masë që këto përbëjnë pretendime monetare ndaj Ndërmarrjes.

C. Që nga 8 Nëntor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit do të shërbejë si Administratore e Ndërmarrjeve të cekura më poshtë. Agjencia do të shërbejë në këtë cilësi gjatë tërë procesit të riorganizimit.

D. Në përputhje me Nenin 17 të Ligjit, Agjencia Kosovare e Privatizimit brenda treqindëgjatëdhjetë ditë (360) do të publikojë edhe një njoftim ("Njoftimi për Afatin e Kërkesave") që do të ofrojë hollësi për mënyrën e parashtrimit të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit dhe caktimin e afatit për parashtrimin e këtyre Dëshmive për Kërkesë dhe Dëshmive për Interes.

E. Vetëm Kreditorët e Regjistruar, sipas përcaktimit në Ligj, do të kenë mundësi të votojnë për Planin e Riorganizimit të Ndërmarrjes.

F. Të drejtat dhe interesat e kreditorëve janë të mbrojtura me Pjesën IV të Ligjit. Neni 17.2 i Ligjit parasheh obligimet e Administratorit të ekzistimit e kërkesës apo interesit të pretenduar ndaj Ndërmarrjeve më poshtë apo asetëve të tyre. Neni 17.10 i Ligjit parasheh që brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas pranimit të Dëshmisë së Kërkesës apo Dëshmisë së Interesit apo brenda kohës shtesë që mund të lejohet nga Gjykata, Administratori njofton personin që ka dorëzuar Dëshminë e Kërkesës apo Dëshminë e Interesit në fjalë për të gjitha vërejtjet që ka në lidhje me to. Në përputhje me nenin 19 të Ligjit, Administratori do të caktojë një datë për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave. Me kërkesë të Administratorit, Gjykata mund të zgjasë periudhën kohore për mbajtjen e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve për tridhjetë (30) ditë shtesë. Sipas nenit 20 të Ligjit, Komisioni i Kreditorëve do të caktohet nga Gjykata gjatë Mbledhjes së Parë të Kreditorëve. Komisioni i Kreditorëve do të përbëhet nga një grup Personash që në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohen si përfaqësues të të gjithë kreditorëve. Komisioni i Kreditorëve do të përfshijë dy (2) Përfaqësues të Punonjësve dhe së paku tre (3) mirëpo jo më shumë se shtat (7) kreditorë tjerë jo-punonjës të cilët në kohë kanë parashtruar Dëshmitë e Kërkesës tek Administratori brenda apo para Afatit të Kërkesave. Në përputhje me Nenin 22 të Ligjit, në afat prej nëntë (9) muajve pas datës së publikimit të Njoftimit për Afatin e parashtrimit të Kërkesave, Administratori përgatit Planin e Propozuar për Riorganizim dhe e dorëzon atë para Komisionit të Kreditorëve. Brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të Planit të Propozuar të Administratorit për Riorganizim, çdo Kreditor i Kualifikuar apo Grup i Kualifikuar i Kreditorëve që planifikon të përgatis apo dorëzoj Planin Alternativ për Riorganizim, i dërgojë Komisionit të Kreditorëve, Administratorit dhe Gjykatës "Njoftimin e Qëllimit për Parashtrimin e Planit Alternativ të Riorganizimit". Tërë teksti i ligjit mund të gjendet në:

[https://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20Riorganizimin%20e%20Ndermarrjeve%20te%20Caktuara%20\(shqip\).pdf](https://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20Riorganizimin%20e%20Ndermarrjeve%20te%20Caktuara%20(shqip).pdf)

Lista e ndërmarrjeve në këtë Njoftim:

Trepça Ndërmarrjet Thelbësore që përbëhen nga: (a) NSh Minierat dhe Flotacionet Stantrg Fi 690/89, (b) NSh Minierat dhe Flotacionet Kishnic dhe Novo Berdo Prishtinë, (c) NSh Minierat dhe Flotacionet Trepça Kopaonik, Leposaviç Fi 804/89, (d) NSh Metalurgjia Plumbit Zvečan Fi 684/89, (e) NSh Metalurgjia Zinkut, Mitrovicë Fi 983/90, (f) NSh Industria Kimike, Mitrovicë (g) NSh Industria Akumulatorëve Trepça, Mitrovicë Fi 697/89, (h) NSh Fabrika e Pajisjeve Përpunuese, Mitrovicë Fi 683/89, (i) NSh Trepça Energjitika, Zvečan - (j) NSh Intituti Trepça, Zvečan (k) NSh Trepça Trans, Zvečan (l) NSh Qendra Llogaritare, Mitrovicë, (m) NSh Trepça Komerc, Mitrovicë Fi 669/89, (n) NSh Standard Trepça, Mitrovicë Fi 666/89, (o) NSh Laboratori Trepça, Zvečan Fi 762/89, (p) Mjekësia e Punës, (q) Banka Trepça, Institucion Financiar, Zvečan Fi 85/77 dhe Fi 705/89, (r) Mbrojtja Pronës, Zvečan – së bashku me entitetin që i referohen si "KXMK Trepça" (Kombinati Xehtar, Metalurgjik, Kimik Trepça) Fi 881/89, dhe Trepça Ndërmarrjet e Tjera që përbëhen nga: (s) PTP Proleter, Leposaviç.

Agjencia Kosovare e Privatizimit,
Departamenti Ligjor,
Tel: ++381-38-500-400,
E-mail në trepca@pak-ks.org,
Faqja e internetit: www.pak-ks.org